

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Iute Credit “shtrydh” shqiptarët me interesat ekstreme të kredive, mbush thasët në Shqipëri dhe transfero n miliona euro në Estoni
ADRESA	https://shqip.com/iute-credit-zhvat-shqiptaret-me-interesat-e-larta-te-kredive-mbush-tha-set-ne-shqiperi-dhe-transferon-miliona-euro-ne-estoni/
BURIMI	shqip.com
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 15:49:00 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 19:35:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	3ea4c038a32c6761ed3401c35a30bf83048c81755e9ff7c958acddd7b2a4fcba
TEKSTI	9f70faad0599c30304bce45895c1e25bff3ba0a2d652bd5944c7628d20608ea5
PAMJA	d9e0a5cca0b5314fdbb015cfe84249d9e45a4fbeeec489fafde928f821abdb8a

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	74d1018861c38a087ae33893d764b6482ee6bb4ce112c12c7f43f4435b281f2d
E MËPARSHMJA	516b6d65b9af6b2999e97dac73e557b5008d7d2b1b561ec80961d5c01ad6cf55
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/74d1018861c38a087ae33893d764b6482ee6bb4ce112c12c7f43f4435b281f2d

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Lajme

Iute Credit “shtrydh” shqiptarët me interesat ekstreme të kredive, mbush thasët në Shqipëri dhe transferon miliona euro në Estoni



Shqip

Publikuar: (18.09.2026 21:35:00)



Share



IuteCredit Albania ka ngritur në Shqipëri një biznes që prodhon miliona euro fitim, ndërsa një pjesë shumë e madhe e parave regjistrohet çdo vit si shpenzim ndaj grupit që e kontrollon. Bilanci i vitit 2025 tregon përmasat e këtij mekanizmi. Kompania regjistroi 605.5 milionë lekë, rreth 6.3 milionë euro, vetëm për shërbime menaxhimi, 218.9 milionë lekë ose rreth 2.26 milionë euro për garanci, ndërsa në tabelën e marrëdhënieve me kompanitë e grupit figurojnë edhe 274.3 milionë lekë, rreth 2.84 milionë euro, si interesa ndaj Iute Group.

Llogaria arrin në afro 1.1 miliardë lekë ose rreth 11.4 milionë euro brenda një viti. IuteCredit Albania ndërkohë deklaroi 421.8 milionë lekë fitim neto, rreth 4.36 milionë euro. Për çdo euro fitim neto që mbeti në bilancin shqiptar, rreth 2.6 euro figurojnë në këto tri kategori shpenzimesh me grupin.

Pesha më e madhe fshihet pas dy fjalëve të thjeshta, “shërbime menaxhimi”. Plot 605,551,819 lekë, rreth 6.3 milionë euro, janë regjistruar si kosto e menaxhimit që IuteCredit Albania merr nga grupi. Në të njëjtin vit, të gjithë punonjësit e kompanisë në Shqipëri kushtuan rreth 362 milionë lekë ose 3.74 milionë euro.

Pra IuteCredit Albania shpenzoi rreth 2.5 milionë euro më shumë për menaxhimin e marrë nga grupi sesa për të gjithë personelin e vet në Shqipëri.

Një faturë prej 6.3 milionë eurosh kërkon një llogari po aq të hollësishme. Çfarë shërbimesh ka marrë konkretisht kompania shqiptare për këtë shumë? Sa kushtoi teknologjia, sa administrimi, sa financa, sa marketingu, sa kontrolli i rrezikut dhe sa shërbimet e tjera që kryhen nga qendra e grupit në Estoni? Mbi çfarë baze është vendosur pjesa që duhet të paguajë Shqipëria dhe sa fitim i është shtuar koston nga kompania mëmë?

Mbi 6.3 milionë eurot e menaxhimit vendosen edhe 218.9 milionë lekë, rreth 2.26 milionë euro, për “shërbime garancie”. Edhe kjo shumë kërkon të zbërthehet. Çfarë detyrimi ka garantuar Iute Group në kompaninë shqiptare, sa para janë parantuar, ku i është dhënë

TË FUNDIT

N'SHËNJESTËR



Kadaster e Lorena Goxhobellit, një moçal skandalesh dhe aferash pa fund!

Lajme



Deklarata e fortë: Kompania që u kap me 41 kg kokainë (AMG Food e Arben Goxha), përfitoi nga Qeveria 1 mln € nga fondet e IPARD

Lajme



Kreda vijon të zhvatë qytetarët, si mikrokreda me filozofi grabitqare i ktheu në mjet fitimprurës interesat e larta të huasë

Lajme



Nga Greta Beqiri punonjëse e zyrës së shtypit të profilet anonime/ Pyetjet e porositura të PD-së po e bëjnë Berishën qesharak. Bashkëbisedimi i të shtunës kthehet në parodi

Lajme



Non grata/ Berisha e pranon: Vizën amerikane e mora me lobim, sa para u paguan... Jam i sigurt që Trump e lexoi letrën që i dërgova

Lajme



Banka JET/ Qarkullon paratë e Forex? Si u trash kapitali nga 3 min lekë në 26 milionë €! Ndryshoi emrin dhe manovra mes bosëve izraelit Louis Grant Silver e Idan Avishai

Lajme



“Botoxi” kontrabandë, Dritan Gremi i “Gremi Wellness” përfundon në Gjykatë, por si shpëtoi për të njëjtat akuza doktori i VIP-ave, Skerdi Faria i “Keit”

Lajme



Merret i pandehur Dritan Gremi, pronar i “Gremi Wellness” dhe 11 qendrave estetike. Akuzohet për kontrabandë botoxi dhe evazion fiskal

Lajme



Samir Mane ujdj me SPAK/ Biznesmeni mbërriti në Prokurori pas orarit zyrtar për të shmangur mediat

Lajme



Anëtarja e Rithemelimit të PD: Ja si Berisha mashtroi me vizitën në SHBA

Lajme

garancia dhe çfarë rreziku ka marrë përsipër mëma për të faturuar mbi 2.2 milionë euro brenda një viti?

Vetëm këto dy zëra, menaxhimi dhe garancia, arrijnë në 824.5 milionë lekë ose rreth 8.5 milionë euro. Përballë tyre qëndrojnë rreth 4.36 milionë euro fitim neto të IuteCredit Albania. Fatura e menaxhimit dhe garancisë është pothuajse dyfishi i fitimit që kompania raportoi në Shqipëri.

Shifrat e viteve të mëparshme tregojnë se fluksi ka vite që vazhdon. Në 2020, vetëm shërbimet e menaxhimit kushtonin 214.5 milionë lekë. Një vit më vonë fatura kërceu në 687.7 milionë lekë. Në 2022 arriti 781.8 milionë lekë, në 2023 ishte 651.7 milionë, në 2024 rreth 523.3 milionë dhe vitin e kaluar u ngjiti përsëri në 605.5 milionë lekë.

Vetëm shërbimet e menaxhimit arrijnë kështu në rreth 3.46 miliardë lekë gjatë gjashtë viteve, mbi 30 milionë euro po të merret parasysh kursi i këmbimit në secilin vit. Kur llogarisim edhe garancitë dhe interesat e regjistruara në marrëdhëniet me grupin, shuma shkon në rreth 5.7 miliardë lekë, dhjetëra milionë euro që kanë kaluar në bilanc si kosto të lidhura me kompanitë e së njëjtës pronësi.

Këtu hyn në lojë tatim-fitimi. Shqipëria e taton fitimin e kompanive me 15 për qind. Çdo shpenzim që njihet si kosto zbritet përpara se të llogaritet fitimi mbi të cilin paguhet tatimi. Sa më e madhe kostoja e njohur, aq më e vogël shuma që mbetet për t'u tatuar.

Mjafton të shohësh 605.5 milionë lekë të menaxhimit të vitit 2025 për të kuptuar peshën fiskale. Pesëmbëdhjetë për qind e kësaj shume janë rreth 90.8 milionë lekë ose afro 940 mijë euro. Nëse llogaria zgjerohet edhe te 218.9 milionë lekë të garancisë, dy zërat së bashku arrijnë 824.5 milionë lekë dhe 15 për qind e kësaj shume janë rreth 123.7 milionë lekë, afro 1.28 milionë euro.

Për këtë arsye ligji shqiptar u kërkon kompanive që bëjnë transaksione me pronarin ose me shoqëritë e së njëjtës pronësi të justifikojnë çmimet. Fatura duhet të jetë e krahasueshme me atë që do të paguhej mes dy kompanive të pavarura. Pragu për deklarimin e këtyre transaksioneve është 50 milionë lekë. Vetëm fatura vjetore e menaxhimit të IuteCredit Albania e kalon këtë prag më shumë se 12 herë.

Në këtë histori Tatimet shqiptare kanë qenë brenda kompanisë. Pasqyrat financiare të Iute tregojnë se gjatë vitit 2023 administrata tatimore kontrolloi tatim-fitimin për vitet 2020 dhe 2021. Pikërisht në këto dy vite, vetëm shërbimet e menaxhimit kishin arritur në rreth 902 milionë lekë, mbi 7 milionë euro sipas kurseve të periudhës. Bashkë me garancitë, faturat kalonin 1.2 miliardë lekë.

Pra Tatimet kishin përpara syve një volum të madh faturash mes kompanisë shqiptare dhe grupit që e kontrollon.

A u hapën kontratat që qëndronin pas tyre?

A u kontrollua sa kishte shpenzuar realisht qendra e Iute në Estoni për shërbimet e ofruara në Shqipëri?

A u verifikua mënyra se si këto shpenzime ishin ndarë mes filialeve?

A u kontrollua fitimi që mëma i shtonte faturës?

A u krahasua çmimi me atë që do të kërkonte një kompani e pavarur për të njëjtin shërbim?

Përgjigjet janë të rëndësishme edhe për një arsye tjetër. IuteCredit Albania ka strukturën e vet në Shqipëri dhe paguan rreth 3.74 milionë euro në vit për personelin vendas. Ndërkohë nga Estonia i vjen edhe një faturë prej 6.3 milionë eurosh për menaxhim. Tatimet duhet të kenë parë nëse shërbimet e paguara në Estoni plotësojnë punën e bërë në Shqipëri apo në faturë janë përfshirë funksione që kompania shqiptare i kryen ndërkohë me njerëzit e saj./Pamfleti

©Shqip.com

Interesat e kredive

Iute Credit

Mikrokredi

Shqipëri

N'SHËNJESTËR





Kadaster e Lorena Goxhobellit, një moçal skandalesh dhe aferash pa fund!



Deklarata e fortë: Kompania që u kap me 41 kg kokainë (AMG Food e Arben Goxha), përfitoi nga Qeveria 1 mln € nga fondet e IPARD



Kredo vijon të zhvatë qytetarët, si mikrokredia me filozofi grabitqare i ktheu në mjet fitimprurës interesat e larta të huasë



Nga Greta Beqiri punonjëse e zyrës së shtypit të profilet anonime/ Pyetjet e porositura të PD-së po e bëjnë Berishën qesharak. Bashkëbisedimi i të shtunës kthehet në



Non grata/ Berisha e pranon: Vizën amerikane e mora me lobim, sa para u paguan... Jam i sigurt që Trump e lexoi letrën që i dërgova

Të fundit nga Lajme



Kadaster e Lorena Goxhobellit, një moçal skandalesh dhe aferash pa fund!

Publikuar:



Deklarata e fortë: Kompania që u kap me 41 kg kokainë (AMG Food e Arben Goxha), përfitoi nga Qeveria 1 mln € nga fondet e IPARD

Publikuar:



Kredo vijon të zhvatë qytetarët, si mikrokredia me filozofi grabitqare i ktheu në mjet fitimprurës interesat e larta të huasë

Publikuar:



Nga Greta Beqiri punonjëse e zyrës së shtypit të profilet anonime/ Pyetjet e porositura të PD-së po e bëjnë Berishën qesharak. Bashkëbisedimi i të shtunës kthehet në parodi

Publikuar:



Non grata/ Berisha e pranon: Vizën amerikane e mora me lobim, sa para u paguan... Jam i sigurt që Trump e lexoi letrën që i dërgova

Publikuar:

Banka JET/ Qarkullon paratë e Forex? Si u trash kapitali nga 3 mln lekë në 26 milionë €! Ndryshoi emrin dhe manovra mes bosëve izraelit Louis Grant Silver e Idan Avishai

Publikuar:

"Botoxi" kontrabandë, Dritan Gremi i "Gremi Wellness" përfundon në Gjykatë, por si shpëtoi për të njëjtat akuza doktori i VIP-ave, Skerdi Faria i "Keit"

Publikuar:

Merret i pandehur Dritan Gremi, pronar i "Gremi Wellness" dhe 11 qendrave estetike. Akuzohet për kontrabandë botoxi dhe evazion fiskal

Publikuar:

Të fundit nga Rubrikat



Dhuna ndaj Eduard Kuçit, Gjykata jep vendimin për Jozin

Publikuar:

OBP në workshop-in ndërkombëtar të BERZH, Shqipëria drejtë prokurimit të gjelbër dhe social

Publikuar:

Kompozitori dhe DJ Rinor Kastrati, në bashkëpunim me MP3.ofc dhe James Hersey, publikojnë këngën e re "Miss You"

Publikuar:



Kadaster e Lorena Goxhobellit, një moçal skandalesh dhe aferash pa fund!

Publikuar:

Dhjetë ditë në shesh, një thirrje për të gjithë politikën: Mjaft më!

Publikuar:

Flet Ziza Pajaziti: Si hyra 2 herë në burg për takim me Haxhiun. E kam bashkëjetues, bëmë takim familjar

Publikuar:

Skandal në Champions League! Tifozët serbë shfaqin sërish banerin "Kosovo is Serbia"

Publikuar:

Dua Lipa padit Samsung, kërkon 15 mln dollarë dëmshpërblim

Publikuar:

Të fundit në Shqip.com



Kadaster e Lorena Goxhobellit, një moçal skandalesh dhe aferash pa fund!

Publikuar:



Deklarata e fortë: Kompania që u kap me 41 kg kokainë (AMG Food e Arben Goxha), përfitoi nga Qeveria 1 mln € nga fondet e IPARD

Publikuar:



Kredo vijon të zhvatë qytetarët, si mikrokredia me filozofi grabitqare i ktheu në mjet fitimprurës interesat e larta të huasë

Publikuar:



Nga Greta Beqiri punonjëse e zyrës së shtypit të profilet anonime/ Pyetjet e porositura të PD-së po e bëjnë Berishën qesharak. Bashkëbisedimi i të shtunës kthehet në parodi

Publikuar:



Non grata/ Berisha e pranon: Vizën amerikane e mora me lobim, sa para u paguan... Jam i sigurt që Trump e lexoi letrën që i dërgova

Publikuar:

Banka JET/ Qarkullon paratë e Forex? Si u trash kapitali nga 3 mln lekë në 26 milionë €! Ndryshoi emrin dhe manovra mes bosëve izraelit Louis Grant Silver e Idan Avishai

Publikuar:

"Botoxi" kontrabandë, Dritan Gremi i "Gremi Wellness" përfundon në Gjykatë, por si shpëtoi për të njëjtat akuza doktori i VIP-ave, Skerdi Faria i "Keit"

Publikuar:

Merret i pandehur Dritan Gremi, pronar i "Gremi Wellness" dhe 11 qendrave estetike. Akuzohet për kontrabandë botoxi dhe evazion fiskal

Publikuar:

Lajme

Balkan
Botë
Gjykata Speciale
Shqiptare
Ukraina

Sport

Ndërkombëtar
Shqiptar

Rozë

Ndërkombëtar
Shqiptar

Kulturë

Kino
Libra
Muzikë

Art Jetese

Horoskopi
Moda
Shëndeti
Ushqime

Ekonomi

Biznes
Marketing
Tregjet

Teknologji

Auto
Shkencë

OP-ED

Analiza
Editoriale
Kolumne



Albmedia
1000 Tirane - Albmedia

Marketing:

Rreth Shqip.com Etika Redaktoriale Reklamat dhe të ardhurat Privacy Policy





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.